



Kanton Zürich  
Bildungsdirektion  
**Volksschulamt**  
Besondere Förderung, Sektor Sonderpädagogik

Kontakt: Walchestrasse 21, 8090 Zürich  
Telefon 043 259 22 91, sonderpaedagogisches@vsa.zh.ch

14. August 2018  
1/3

## **Informacione për prindërit – Shkollimi special**

**Të dashur prindër,**

**Nxënësve me një të metë ose me probleme të rënda në zhvillim u qëndrojnë në dispozicion ofertat e shkollimit special. Këtu bëhet fjalë për të metat mendore, për ato trupore, për probleme të të shikuarit, të të dëgjuarit, të të folurit si dhe për çrregullime nga spektri i autizmit, pengesa të rënda në të mësuar dhe probleme në sjellje. Në vijim ne do t'ju informojmë për detyrat e shkollimit special dhe të drejtat Tuaja në këtë kontekst.**

### Kur është i nevojshëm shkollimi special?

Një shkollim special merret në konsideratë, nëse nxënësja ose nxënësi nuk përkrahen siç duhet me ofertat e veçanta pedagogjike në shkollën e rregullt.

Në fillim bëhet gjithmonë një bisedë vlerësuese në shkollë. Prindërit, eventualisht së bashku edhe me fëmijën e tyre, mësuesit, pedagogun e shkollës për fëmijë me nevoja speciale, terapeutën ose terapeutin si dhe edukatoren për edukim të hershëm të fëmijëve me nevoja speciale diskutojnë gjendjen momentale dhe paraqesin, në rast se vie në pyetje ndonjë shkollim i veçantë i fëmijës, edhe një kërkesë për shqyrtim psikologjik-shkollor të fëmijës. Shqyrtimi duhet të tegojë në është i nevojshëm një shkollimi special.

Në rast nevoje, Shërbimi Këshillues Psikologjik - Shkollor inkuadron edhe persona të tjerë profesional (p.sh. mjekë specialistë). Në një bisedë tjetër vlerësuese në shkollë me prindërit diskutohet raporti nga shqyrtimi psikologjik-shkollor dhe i parashtrohet një propozim Komisionit Shkollor.

Komisioni Shkollor, i mbështetur në raportin e shqyrtimit psikologjiko-shkollor dhe pas dëgjimit të prindërve, vendos për nevojën e shkollimit special dhe formën e zbatimit të tij. Deri në ç'nivel mund të marrë mësim një nxënës ose një nxënës me nevojë të arsimimit special në klasën e rregullt, këtë e vlerëson dhe e vendos Komisioni Shkollor në përputhje me rrethanat ekzistuese. Ai mbështetet në këtë rast në raportin e Shërbimit Psikologjik - Shkollor, në ekspertizat e tjera të mundshme profesionale, si dhe në vlerësimet e dhëna nga shkolla e rregullt dhe nga prindërit e fëmijës ose të të riuat a të resë përkatëse.

### Ofertë

Shkollimi special mund të integrohet, varësisht nga nevojat e fëmijës ose të rinjve, në një shkollë të rregullt, në një shkollë speciale ditore ose në një konvikt special shkollor:

#### *Shkollimi special i integruar (në klasën e rregullt)*

Plani përkrahës përpilohet sipas nevojave individuale të secilës nxënës përkatësisht të secilit nxënës. Përveç mësimit të mësuesit të klasës së rregullt, mund të caktohen edhe format përkrahëse si në vijim:

- Mësim në grup (Teamteaching)
- Përkrahje individuale ose në grupe të vogla
- Terapi
- Shoqërim social-pedagogjik
- Mbështetje nëpërmjet asistimeve



- Konsultim profesional specifik në lidhje me të metat për mësuesit dhe prindërit

Në rast nevoje mund të aranzhohet edhe një përkujdesje jashtëshkollore, në kuadër të ofertave përkatëse të komunës, nëse është e nevojshme edhe me persona të tjerë përkrahës.

#### *Shkollimi special ditor*

Nxënësja ose nxënësi frekuenton mësimin në një klasë të shkollës speciale dhe në rast nevoje bën edhe terapi. Para dhe pas mësimit në shkollë si dhe gjatë mesditës ofrohet një përkujdesje social- pedagogjike në përputhje me orarin e punës së shkollës speciale.

Në rast nevoje mund të ofrohet një përkujdesje tjetër jashtë shkollës në shkollën speciale ose në komunën e banimit. Në qoftë se fëmija nuk mund ta bëjë vetë rrugën për në shkollë, atëherë organizohet për të edhe transporti i duhur.

#### *Konvikti i shkollës*

Nxënësja ose nxënësi frekuenton mësimin në një klasë të shkollës speciale dhe në rast nevoje bën edhe terapi. Përkujdesja social-pedagogjike në konviktin e shkollës i përshtatet nevojave të fëmijës ose të riut (sipas nevojës deri në 365 ditë në vit). Në qoftë se fëmija nuk mund ta bëjë vetë rrugën për në shkollë, atëherë organizohet për të një mjet i përshtatshëm transporti.

#### Financimi

Komuna dhe kantoni marrin përsipër të gjitha shpenzimet që duhen paguar për shkollimin special, terapitë, përkujdesjen social-pedagogjike (në kuadër të orarit të punës të shkollës speciale) edhe transportin.

Prindërit marrin përsipër:

- Kontributet për ushqim, në rast se nxënësja apo nxënësi ushqehet në shkollë (shih vendimin mbi «Kontributet për ushqim të prindërve» («Verpflegungsbeiträge Eltern», [www.zh.ch](http://www.zh.ch) → Finanzen & Infrastruktur → Budgetgrundlagen Gemeinde)
  - Shpenzimet për ofertat për përkujdesje jashtëshkollore në kuadër të shkollimit special integrativ sipas rregullorës mbi tarifatat të komunës Tuaj
  - Shpenzimet për ofertat mbi integrimin që bëhen jashtë orarit të punës së shkollës speciale ditore dhe në përputhje me rregulloren mbi tarifatat të komunës Tuaj
  - Shpenzimet për ofertat për përkujdesje jashtë orarit të punës së shkollës speciale në përputhje me rregulloren mbi tarifatat të komunës Tuaj
  - Shpenzimet tjera plotësuese sipas marrëveshjes së bërë me konviktin shkollor
- Ofertat jashtëshkollore të përkujdesjes në kuadër të shkollimit special të integruar në përputhje me rregulloren mbi tarifatat të komunës Tuaj.
  - Ofertat për përkujdesje jashtë orarit të punës së shkollës speciale në përputhje me rregulloren mbi tarifatat të komunës Tuaj
  - Shpenzimet tjera plotësuese sipas marrëveshjes së bërë me konviktin shkollor.

#### Të drejtat e prindërve



Prindërit bashkëpunojnë në kuadër të bisedës vlerësuese që zhvillohet të paktën një herë në vit në shkollë në planifikimin e masave përkrahëse ( përcaktimin e qëllimeve prioritare përkrahëse) dhe në vlerësimin e domosdoshmërisë së ekzistimit të masës së shkollimit special.

Prindërit që në fillim të shkollimit special informohen për:

- të drejtat dhe mundësitë e pjesëmarrjes së tyre
- mbi rregullimin e saktë të shkollimit special, përkatësisht të konceptit të përkujdesjes, dhe terapeutik të shkollimit special
- organet kontrolluese përkatëse (Komisionin Shkollor ose bartësin e shkollës speciale dhe Drejtorinë e Arsimit të Kantonit të Cyrihut, Entin e Shkollimit Fillor, Sektorin e Pedagogjisë Speciale, telefoni: 043 259 22 91).

Kundër të gjitha vendimeve të Komisionit Shkollor mund të bëhet ankesë tek Këshilli i Rrethit (Bezirksrat) gjegjësisht.

#### Informacione / konsultim

Regjistri i shkollës speciale nën: [www.zh.ch/schulen](http://www.zh.ch/schulen) → Bildung → Schulen → Sonderschulen

Koncepti në kuadër të shkollimit special të integruar nën: [www.zh.ch/sonderschulung](http://www.zh.ch/sonderschulung) → Informationen für Sonderschulen

- Pro Infirmis, zyrë konsultimi për prindër, Tel. 044 299 44 11, [www.proinfirmis.ch](http://www.proinfirmis.ch)
- Procap- shërbim juridik për njerëzit me të meta, Tel. 062 206 88 77, [www.procap.ch](http://www.procap.ch)

#### Zyrat përkatëse për të metat specifike:

VSA (Volksschulamt – Enti për Shkollim Fillor) posedon një listë me emrat e këshillimoreve për këshillime për të meta specifike/ për tipin e shkollës, regjionin dhe të dhënat mbi kontaktet (linku [www.zh.ch/sonderschulung](http://www.zh.ch/sonderschulung) → Integrierte Sonderschulung (ISR/ISS)